




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 16.07.2018

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 16, nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 119, të datës 12.06.2018, bën këtë:

**NJOFTIM
PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK PËR PROGRAMIN
TREVJEÇAR TË BANIMIT 2018-2020**

Njoftohen qytetarët dhe të gjithë të interesuarit tjerë, se diskutimi publik për “Programin Trevjeçar të Banimit 2018-2020 në Komunën e Fushë-Kosovës”, është i hapur nga data: 16.07.2018-29.07.2018.

Për sqarime dhe konsultime lidhur me “Programin Trevjeçar të Banimit 2018-2020 në Komunën e Fushë-Kosovës”, mund të drejtoheni në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kati i parë, në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës, rruga ‘Tahir Zemaj’.


Takimi për konsultim publik do të mbahet më datë: **24.07.2018, në orën 10:00h**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës.

Njoftimi për diskutim publik publikohet në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Përsëritje!



**KOMUNA
FUSHË-KOSOVË**



**PROGRAMI KOMUNAL TREVJEÇAR PËR BANIM
2018-2020**

Prill 2018

LLOJI I DOKUMENTIT: PROGRAMI KOMUNAL PËR BANIM 2018-2020

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

VENDIMI Nr. 1106

**GRUPI PUNUES - KOMISIONI PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR
PËR BANIM**

Nr.	Emri dhe mbiemri	Drejtoria	Përgjegjësia në Komision
1	Hysen Sllamniku	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Kryesues
2	Antigona Sahiti	Drejtoria e Planifikimit Urban	Anëtar
3	Bardhyl Koiçiçi	Drejtoria e Financave dhe Planifikimit të Buxhetit	Anëtar
4	Hasan Gjyrevci	Drejtoria e Administratës	Anëtar
5	Zoran Kitiç	Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete	Anëtar

Tabela 1: Grupi Punues për Hartimin e Programit Trevjeçar

Ky program është realizuar me ndihmën e projektit “Banimi, e Drejtë Themelore Njerëzore” financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga OJQ Developing Together.

Komisioni Komunal i angazhuar në realizimin e programit falënderon ekspertët e DT-së në ndihmën e dhënë.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje	4
2. Vizioni.....	5
3. Synimi i Programit	5
4. Objektivi	5
5. Procesi i hartimit të programit	6
6. Korniza ligjore	7
7. Pozita gjeografike	7
8. Karakteristikat demografike.....	8
Popullsia.....	8
Migrimi	8
Shtimi natyror	8
Jetëgjatësia	9
9. Punësimi dhe papunësia	10
10. Ambienti biznesor	10
11. Të ardhurat	10
12. Të ardhurat mesatare/gjendja sociale	10
13. Nr. i familjeve përfituese të asistencës sociale	11
14. Ekonomia/potenciali i komunës.....	11
15. Buxheti i paraparë për vitet në vijim.....	12
16. Planifikimi hapësinor dhe infrastruktura	12
17. Gjendja faktike - analiza	13
18. Kërkesat faktike për përkrahje	14
18.1. Kategoritë e synuara	15
18.2. Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë	15
19. Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës së trajtimit të tyre	16
20. Veprimet kryesore që do të ndërmerren.....	16
21. Programet.....	16
21.1 Ndërtimi i njësive të reja banesore të cilat do të jepen me qira jofitimprurëse	17
21.2 Adaptimi i objekteve ekzistuese për banim	17
22. Analiza e fakteve dhe projektet në bazë të programeve	19
23. Justifikimi i veprimeve dhe shpjegimi i rezultateve të pritshme	22
24. Themelimi i sektorit të banimit.....	23
25. Mënyra e financimit të programeve trevjeçare	23
26. Burimet për financimin e programeve trevjeçare të banimit	24
27. Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës	24
28. Ndërlidhja e programeve me programet e përgjithshme dhe orientimet e politikave të qeverisjes qendrore	24
29. Instrumentet e mbikëqyrjes.....	25
30. Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve	25
31. Masat që janë marrë për respektimin e kuadrit ligjor	25
32. Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transperencës.....	25
33. Çështje të tjera.....	26
34. Analiza sot	26
35. Përfundimi.....	28

1. Hyrje

Komuna e Fushë-Kosovës e konsideron banimin si një ndër çështjet shumë të rëndësishme me të cilën përballen qytetarët e vet. Përmes këtij programi synohet që të ndihmohet një numër i caktuar i qytetarëve duke iu siguruar strehim për një periudhë të caktuar kohore. Ky program është bërë në përputhje me Ligjin për financimin e programeve të veçanta për banim 03L – 164’.

E drejta për banim adekuat është e drejtë themelore njerëzore e cila njihet nga shumë deklarata dhe konventa ndërkombëtare. Sipas deklaratës universale të të drejtave të njeriut nga viti 1948 - Neni 25.1 thuhet se: ‘çdokush ka të drejtë për një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe familjes së tij, përfshirë ushqimin, veshmbathjen, strehimin dhe shërbimin mjekësor, dhe të drejtën për siguri në rast papunësie, sëmundje, paaftësie, vejërie, plakje, ose mungesë e mjeteve të jetesës në rrethana jashtë kontrollit të tij’.

Edhe qeveria e Kosovës e njeh të drejtën për banim të secilit qytetar të vet. Kjo është e rregulluar edhe me legjislacion. Në vitin 2010 Parlamenti i Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 03/L – 164 ‘Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit’. Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t’i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit.

Pjesë mjaft e rëndësishme e këtij ligji është mundësia që ky ligj u jep institucioneve lokale (komunave) dhe institucioneve qendrore (MMPH-së) për të siguruar banim përmes financimit të programeve të veçanta për banim. Kjo parashihet të bëhet përmes tri skemave:

- a). Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- b). Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit dhe
- c). Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

2. Vizioni

Komuna e Fushë-Kosovës të jetë një vend me kapacitete gjithëpërfshirëse të ndërtimit dhe banimit atraktiv dhe mbështetëse për kategori të caktuara, me një popullsi aktive dhe nivel të lartë të kualitetit të jetës dhe kulturës për të gjitha komunitetet.

3. Synimi i Programit


Synimi i këtij programi është krijimi i kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm, në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.

4. Objektivi

Objektiv i gjithmbarshëm i Komunës së Fushë-Kosovë është që përmes këtij programi të bëjë tërheqjen e investimeve dhe të bëjë përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të jetesës në përgjithësi, që rezulton në reduktimin e numrit të familjeve që kanë nevojë për mbështetje në fushën e banimit.

5. Procesi i hartimit të programit

Hierarkia në proces të hartimit të programit



Vendimet shtesë për përpilim të programit:

- Vendimi i Kryetarit të Komunës për formimin e 'Komisionit për hartimin e programit komunal të banimit 2018-2020' (5 anëtarë);
- Definimi i detyrave të punës së Komisionit;
- Drejtoritë mbështetëse - mbledhja e informatave për fushën e banimit nga sektorët që ndërlidhen me të brenda Komunës dhe nga institucionet e ndryshme;
- Dokumentet komunale;
- Struktura e buxhetit komunal;
- Identifikimi i grupeve të synuara;
- Përgatitja e dokumentit;
- Procedurat e miratimit të dokumentit;
- Shqyrtimi publik;
- Aprovimi nga Kuvendi i Komunës;
- Zbatimi dhe Monitorimi.

Informatat relevante nga fushat përkatëse të Komunës dhe procesi i hartimit:

- Strategjia e Zhvillimit Ekomomik të Komunës së Fushë-Kosovës;
- Plani Zhvillimor Komunal dhe Plani Zhvillimor Urban;
- Planet Rregulluese Urbane të Fushë-Kosovës;
- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis.

6. Korniza ligjore

- ‘Ligji Nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit’;
- Udhëzimi Administrativ - Për Përmbajtjen e Kontratës për Banesën me Qira Jofitimprurës;
- Udhëzimi Administrativ - Për përmbajtjen e bonusit të banimit;
- Udhëzimi Administrativ - Për Procedurat e Përfitimit nga Programet e Veçanta të Banimit;
- Udhëzimi Administrativ - Për Normat e Banimit për Programet e Veçanta të Banimit;
- Udhëzimi Administrativ - Për Procedurat e Shpalljes së Programeve të Veçanta të Banimit;
- Udhëzimi Administrativ - Për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit;
- ‘Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale’;
- Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit;
- Statuti i Komunës;
- Dokumentet planore – urbane;
- Ligji për Procedurat Administrative.

7. Pozita gjeografike

Fushë-Kosova është qytet që ka pozitë qendrore në Rrafshin e Kosovës. Si Komunë u konsolidua mjaft vonë, në vitin 1989, e lokalizuar 7 km në perëndim të kryeqytetit të Kosovës. Fushë-Kosova njihet si Komunë shumetnike ku banojnë komunitete të ndryshme, krahas shumicës shqiptare.

Komuna jonë përbëhet prej 14 zonave kadastrale, me një sipërfaqe prej rreth 100 km² dhe me një lartësi mbidetare 550 m. Në lindje kufizohet me Komunën e Prishtinës, në veri

kufizohet me Komunën e Kastriotit, në jug kufizohet me Komunën e Lipjanit, ndërsa në perëndim kufizohet me Komunën e Drenasit.

Komuna e Fushë-Kosovës jozyrtarisht ka një popullsi prej rreth 50,000 mijë banorë me një dendësi shumë të lartë, 420 banorë në një kilometër katror. Mesatarja e anëtarëve për një familje është rreth 6, rreth 40% e popullatës jeton në qytet – Fushë-Kosovë, kurse 60 % në fshatra.

Sistemi i Arsimit në Fushë-Kosovë përbëhet nga:

- 2 institucione parashkollore;
- 10 shkolla fillore;
- 4 shkolla të mesme.

Pas luftës së fundit më 1999 janë të theksuara lëvizjet e popullsisë. Vlerësohet se diku rreth 5 - 7% e popullsisë ka lëvizur në drejtim të qendrave urbane, kryesisht në kryeqytet. Përqindja e të shpërngulurve (rreth 15%) është edhe më e lartë, nëse merret parasysh edhe popullata në diasporë.

8. Karakteristikat demografike

Popullsia

Komuna e Fushë-Kosovës, sipas regjistrimit të fundit nga ESK (2011), zyrtarisht ka një popullsi prej rreth 34,827 banorë, me një dendësi shumë të lartë, 420 banorë në një kilometër katror, rreth 40% e popullatës jeton në qytetin e Fushë-Kosovës, kurse 60 % në fshatra.

Migrimi

Pas luftës janë të theksuara lëvizjet e popullsisë. Vlerësohet se diku rreth 5 - 7% e popullsisë ka lëvizur në drejtim të qendrave urbane, kryesisht në kryeqytet. Përqindja e të shpërngulurve (rreth 15%) është edhe më e lartë, nëse merret parasysh edhe popullata në diasporë.

Po ashtu kemi një numër të madh të popullatës të ardhur nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja.

Komuna e Fushë-Kosovës po zhvillohet çdo ditë dhe është bërë një vend atraktiv i zhvillimit të biznesit si dhe vend tërheqës për të jetuar.

Shtimi natyror

Numri aktual i banorëve dhe parashikimi i shtimit të popullsisë është e dhënë thelbësore për planifikim hapësinor. Edhe pse parashikimi nuk mund të jetë shumë i saktë në rast të mungesës së informatave të sakta, për llogaritjen e shtimit të popullsisë së Komunës së

Fushë-Kosovës marrim shkallën e shtimit 1.6%, shkallë e përvetësuar kjo edhe në Planin Hapësinor të Kosovës.

	Numri i parashikuar i popullsisë në komunë.	50.000
	Numri i tanishëm i popullsisë në komunë.	34827
	Shkalla e shtimit vjetor të popullsisë	1.6
	Numri i viteve të parashikuara	10
	$N_k = N_r \cdot (1 + P/100)^n$	

Tabela 2. Shtimi i popullsisë në Komunën e Fushë-Kosovës

Numri i marrë nga shënimet e fundit në K.K. Fushë-Kosovë, gusht 2011 – Burimi ESK.

Jetëgjatësia

Treguesi i zhvillimit njerëzor;

Sistemi edukativ-arsimor në Komunën e Fushë-Kosovës është i organizuar dhe funksionon në tri nivele:

- arsimin parashkollor;
- arsimin fillor;
- arsimin e mesëm.

Arsimi parashkollor në institucione publike funksionon në një çerdhe – kopsht, me 180 fëmijë dhe në ato private;

Arsimi fillor zhvillohet në 9 shkolla/objekte me 6,206 nxënës;

Arsimi i mesëm zhvillohet në 3 shkolla/objekte me 1509 nxënës;

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sistemin arsimor në Komunën e Fushë-Kosovës është 463 persona.

9. Punësimi dhe papunësia

Sa i përket punësimit në sektorin e institucioneve të administratës publike janë të punësuar 723 punëtorë, ndërsa në sektorin privat nuk ka shifra të sakta të të punësuarve.

Sipas informacioneve të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Punësimit (SIMP) në Komunën e Fushë-Kosovës në tre vitet e fundit ka të regjistruar 1,085 punëkërkues, prej tyre 654 punëkërkues të gjinisë mashkullore dhe 431 punëkërkues të gjinisë femërore.

Mirëpo, këto shifra nuk korrespondojnë me gjendjen reale sepse numri i punëkërkuesve dhe numri i të punësuarve është më i madh të cilët nuk janë lajmëruar në zyrat e punësimit, respektivisht firmat e ndryshme nuk i kanë lajmëruar si punëtorë të punësuar. Ky është një problem i gjerë i cili prek tërë Kosovën dhe duhet të trajtohet në nivel qendror.

10. Ambienti biznesor

Komuna e Fushë-Kosovës ka krijuar një klimë të mirë për zhvillimin e biznesit. Ka një pozitë të volitshme gjeografike (afërsia me kryeqytetin - Prishtinën), ka rritje të numrit të popullatës si dhe ka trend të zhvillimit ekonomik.

Në Fushë-Kosovë janë aktive 1,160 biznese me një numër prej rreth 2,000 të punësuarve. Kryesisht dominojnë bizneset tregtare dhe ato shërbyese.

11. Të ardhurat

Të punësuarit në sektorin publik

Të punësuarit në sektorin privat

Bizneset e ekonomive familjare

Të hollat e dërguara nga jashtë

Të ardhurat nga bujqësia

Pensionet

Ndihma sociale

12. Të ardhurat mesatare/gjendja sociale

Sa i përket të ardhurave mesatare ato janë në nivel të Kosovës. Komuna e Fushë-Kosovës e ka ngritur mirëqenien sociale në të gjitha fushat: shëndetësi, arsim, infrastrukturë, shërbime publike, etj. Me këtë ka krijuar kushte më të volitshme për jetë.

Sfidë janë familjet/personat e komunave tjera (Medvegjë, Preshevë, Bujanovc) të cilët jetojnë në Komunën e Fushë-Kosovës por nuk kanë prona dhe nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

13. Nr. i familjeve përfituese të asistencës sociale

Periudha	Numri i familjeve
2013	780 familje në muaj (për çdo muaj ndryshon ky numër)
2014	750 familje
2015	787 familje
2016	730 familje
2017	780 familje

14. Ekonomia/potenciali i komunës

Përderisa zhvillimi ekonomik është komponentë përbërëse e të gjitha fushave të zhvillimit të Komunës së Fushë-Kosovës, në mënyrë specifike janë identifikuar tri pika kyçe si caqe zhvillimore prioritare për ngritjen e zhvillimit ekonomik të Fushë-Kosovës:

1. Caku 1 – Mbrojtja dhe kultivimi i tokës bujqësore, shtimi i prodhimit agrar, ngritja e agrobizneseve dhe impianteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore;
2. Caku 2 – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, konsolidimi i brezit të bizneseve përgjatë Rrugës M9;
3. Caku 3 – Konsolidimi i turizmit në komunë, funksionalizimi i pikave dhe zonës me potencial turistik në perëndim të komunës, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore si dhe promovimi i turizmit në këto dy fusha;

Të tre këta sektorë janë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik komunal, të cilët mund të prodhojnë vende të reja të punës dhe të plotësojnë zhvillimin ekonomik krahas sektorit të bujqësisë. Prandaj, në Planin Zhvillimor Komunal të Fushë-Kosovës parashihet funksionalizimi i brezit të bizneseve përgjatë kësaj rruge në të cilin Komuna e Fushë-Kosovës do të ofrojë kushte të veçanta për zhvillimin e bizneseve, do t'i stimulojë ato por edhe kontrollojë, e që rrjedhimisht vjel të mirat e fituara nga ky sektor. Është me rëndësi që brezi i biznesit të funksionalizohet në të gjitha aspektet dhe të luftohet biznesi joformal.

15. Buxheti i paraparë për vitet në vijim

	<u>Grandet e parapara</u>	2018	2019	2020
1.	Grandi i përgjithshëm	3,428,529.00	3,397,977.00	3,694,767.00
2.	Grandi për shëndetësi dhe mirëqenie sociale	948,800.00	1,044,335.00	
3.	Gjithsej HVK (të hyrat vetjake të komunës)	2,723,185.00	2,439,993.00	2,524,130.00
4.	Grandi për Arsim	3,190,208.00	4,178,112.00	4,197,502.00
5.	Grandi për Bujqësi	Financohet nga grandi i përgjithshëm		
6.				

Bazuar në trendët zhvillimore në komunë, planifikimi i buxhetit për vitet në vijim, mund të vjen në konsiderim edhe ndarja e buxhetit për programin e banimit kryesisht nga të hyrat vetjake, shëndetësia dhe grandi i përgjithshëm. Komuna e Fushë-Kosovës do të analizojë thellësisht me departamentet financiare mundësinë që në baza vjetore të ndahet buxhet i dedikuar ekskluzivisht për banim. Do të shikohet mundësia që ky buxhet të jetë rreth 1% e buxhetit total të Komunës së Fushë-Kosovës.

16. Planifikimi hapësinor dhe infrastruktura

Sipërfaqja e përfshirë në Plane Urbane

Nr.	Zonat - territori i mbuluar me Plane Urbane	Sipërfaqja totale e Komunës /ha	Sipërfaqja e zonës me PU	Raporti %
1.	Qyteti i Fushë-Kosovës dhe rrethina e ngushtë PZHU dhe PRRU	7,049.860.97 ha		
2.	Vendbanimet PZHU			
3.	Fshati Lismir	847.292.00		
4.	Fshati Kuzmin	1,109.402.00		

Bazuar në të dhënat nga Planet Urbane për zonat urbane janë përkufizuar rregullat e shfrytëzimit të tokës – parametrat urban si: ISHP maks. = 40%, 50%, banimi kolektiv dhe zonat ekonomike ISHP maks. 70% dhe 90%.

Në kuadër të PZHKU-së dhe PZHU-së janë përkufizuar përmbajtjet për zonat dhe vendbanimet, kështu që në kuadër të zonave të banuara fokusohen zonat e caktuara për zhvillimin e banimit sipas programeve si: ‘Zona në Miradi e Epërme’ si potencial për zhvillimin e programeve të banimit.

Zonat e tilla do të jenë pjesë e zonave ekzistuese të banimit.

17. Gjendja faktike - analiza

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS			
Nr. i popullsisë			34,718
Zonat rurale			14,806
Zonat urbane			20,021
Nr. i fshatrave/Nr. i lagjeve			14
Banimi individual	Nr. i objekteve para 1999-ës		-
	Nr. i objekteve pas 1999-ës		
	Etazhiteti mesatar		-
Banimi kolektiv	Para 1999-ës	Nr. i objekteve	9495
		Nj. e banimit	
	Pas 1999-ës	Nr. i objekteve	
		Nj. e banimit	
	Etazhiteti mesatar		-
Statusi pronësor (banim kolektiv) para 1999-ës		Privat (nj. banimi)	-
		Shoqëror (nj. banimi)	-
Raporti banim individual/banim kolektiv në (%)			-
Kyçje në infrastrukturë të objekteve të banimit në (%)			-
Nr. i objekteve të pabanuara			34%
Nr. i objekteve me vlerë kulturo-historike që shfrytëzohen për banim			0
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në (%)			
Ndërtimet ilegale	mbindërtimet		
	ndërtimet tjera		
	ndërtimet në pronë shoqërore		
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit			30
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit			Miradi e Epërme
Nr. i objekteve/nj. banimi të ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët			Komuna për çdo vit ndërton 15 objekte

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS
PROGRAMI KOMUNAL TREVJEÇARI BANIMIT NË KUADËR TË LIGJIT NR. 03/L-164
PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË BANIMIT

		individuale të banimit
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga vlera mes. e qirasë		58
Nr. i objekteve/nj. banimi të favorshme për qira të ulëta të tregut		0
Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që duhet të rinovohen (Miradi e Epërme)		20
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK-ve	1 qendër me 58 njësi banimi
	Vendndodhja /emërtimi	Miradi e Epërme
	Nr. i familjeve	58
	Nr. i banorëve	?
Planet rregulluese - sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen		PZHV, PZHK, PZH Hapësinor

18. Kërkesat faktike për përkrahje

Në Komunën e Fushë-Kosovës në vitin 2016 janë identifikuar 42 raste të cilët kanë parashtruar kërkesa për sigurim të banimit. Po ashtu deri në fund të vitit 2017 Komuna e Fushë-Kosovës ka pranuar edhe 42 raste të cilët kanë kërkuar ndihmë në formë të pagesës së qirasë. Nga këto 42 raste të vitit 2017, Komuna e Fushë-Kosovës i ka aprovuar 12 raste për pagesë të qirasë (bonus banim).

	Kategoritë:	Kërkesa për banim	Të asistuar
1.	Me asistencë sociale	20	6
2.	Kategoritë e dala nga lufta - familjet e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe martirëve		0
3.	Të kthyerit		1
4.	Të riatdhesuarit		5
5.	Të moshuarit		2
6.	Të rinjtë		11
7.	Të punësuarit nga buxheti shtetëror		0
8.	Minoritetet		6
9.	Tregu i banimit		0

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS
PROGRAMI KOMUNAL TREVJEÇARI BANIMIT NË KUADËR TË LIGJIT NR. 03/L-164
PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË BANIMIT

10.	Shitja e banesave në treg		0
11.	Të dhëna me qira		58
12.	Me qira në kushte të caktuara		6
13.	Pa qira		0

Gjendja sipas kërkesave dhe rastet aktuale për banim

18.1 Kategoritë e synuara

Komuna e Fushë-Kosovës kategorizimin dhe specifikimin e nevojave për banim e planifikon në kuadër të bazës ligjore duke qartësuar balancën ndërmjet kategorive të synuara sipas aplikimeve paraprake. Kjo edhe është baza kryesore sipas së cilës do të përcaktohen kriteret e caktuara për familjet përfituese për banim social. Sipas 'Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim' familjet do të listohen duke marrë parasysh karakteristikat sociale dhe ekonomike që presin ndihmën nga autoritetet komunale për të zgjidhur problemet e banimit.

Ndër kategoritë që do të përfitojnë nga programet e banimit parashihen:

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike;
- Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politikë;
- Të kthyerit dhe komunitetet RAE (minoritetet);
- Të riatdhesuarit;
- Të moshuarit;
- Të rinjtë;
- Të punësuarit nga buxheti shtetëror.

18.2 Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë

Në pajtim me dispozitat e 'Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit' kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit;
- Lartësia e të ardhurave
- Gjendja shëndetësore
- Invaliditeti
- Struktura e familjes

Tabela me kritere të sakta gjendet në ligj dhe udhëzime administrative.

19. Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës së trajtimit të tyre

Programi i prezantuar përfshin periudhën trevjeçare për ndihmë me mundësi vazhdimi.

- Rastet sociale të cilat do të klasifikohen me bonus banimi – Komisionet Komunale dhe Vendimi i K.K.-së;
- Të riatdhesuarit;
- Raste me prioritet në fazën e parë.

20. Veprimet kryesore që do të ndërmerren

Ky program ka disa objektiva:

01. Sigurimin e banimit për 30 familje brenda periudhës trevjeçare. Këto familje do të ndihmohen përmes dy skemave:

- 10 familje do të ndihmohen përmes renovimit të objekteve në fshatin Miradi e Epërme;
- 20 familje do të ndihmohen përmes pagesës së qirasë. Në këtë grup hyjnë edhe 14 familje të cilave Komuna e Fushë-Kosovës veçse është duke iu paguar qiranë nga viti 2015, 2016 dhe 2017;

02. Formimin e Sektorit për Banim.

21. Programet

Duhet të merren parasysh tre mënyra të ndihmës, si në vijim, të cilat janë në përputhje me ligj:

- banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët të cilat jepen me qira;
- banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Programet e identifikuara si adekuate për nevojat për banim në Komunën e Fushë-Kosovës:

21.1 Ndërtimi i njësive të reja banesore të cilat do të jepen me qira jofitimprurëse

Komuna e Fushë-Kosovës nuk posedon tokë adekuate e cila do të mund të shfrytëzohej për ndërtimin e njësive të reja banesore, prandaj për këtë program të prezantuar kjo mënyrë/skemë nuk merret parasysh fare. Ky vlerësim yni për këtë lloj metode bëhet bazuar në përvojat e mëhershme të zbatimit të saj e cila ka rezultuar joadekuate dhe ka shkaktuar mjaft probleme, siç janë:

- Menaxhimi i mirëmbajtjes së këtyre ndërtesave që është mjaft problematik;
- Rastet më të rënda sociale izolohehen në objekte të veçuara e cila u vështirëson këtyre familjeve integrim në shoqëri;
- Familjet të cilat vendosen në këto objekte në të shumtën e rasteve i konsiderojnë këto objekte si të vetat dhe është shumë vështirë që të largohen nga aty pas skadimit të kontratës;

21.2 Adaptimi i objekteve ekzistuese për banim

Këtu hyjnë objektet e dala jashtë funksionit si rezultat i mbylljes së ndonjë veprimtarie të cilat mund të adaptohen në funksion të banimit për programet e veçanta të banimit, të cilat janë në pronësi komunale apo pronësi shoqërore tjetër e që mund të transferohet në pronë komunale. Komuna e Fushë-Kosovës i posedon disa objekte të tilla në fshatin Miradi e Epërme. Përmes inxhinierëve të DT-së është bërë një vlerësim i përafërt lidhur me çmimin e renovimit të këtyre objekteve.



Foto 1. Planimetria e objekteve në Miradi të Epërme që mund të renovohen




Foto 2. Pamja e objekteve në Miradi të Epërme

Gjatë viteve 1990, në periudhën e shpërbërjes së ish/Republikave të Jugosllavisë, në Komunën e Fushë-Kosovës, gjegjësisht në fshatin Miradi e Epërme, janë ndërtuar 34 objekte të banimit me 60 njësi të banimit për nevojat e refugjatëve serbë të ish/Republikës së Kroacisë.

Në vitin 1999 pas ngjarjeve në Kosovë këto familje janë shpërngulur në drejtim të pa njohur. Pas vitit 1999 në këto objekte banimi në mënyrë spontane janë vendosur familjet e fshatit Miradi e Epërme dhe rrethinës të cilëve iu kanë shkatërruar (djegur) shtëpitë dhe kanë mbetur pa strehë.

Deri në vitin 2009 këto objekte banimi i ka menaxhuar Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa pas vitit 2009 i menaxhon Komuna e Fushë-Kosovës.

Këto objekte që 30 vite nuk janë renovuar dhe në ndërkohë janë demoluara nga koha dhe familjet të cilat kanë qëndruar përkohësisht.

Një numër nga këto ndërtesa janë të uzurpuara dhe për momentin nuk mund të shfrytëzohen.

Sidoqoftë, me programin e prezantuar planifikohet renovimi i 10 ndërtesave të cilat pastaj përmes procesit transparent do të ndahen për persona në nevojë për banim sipas kriterëve të caktuara në ligj dhe në udhëzime administrative lidhur me banimin social.

Sipas një analize të përafërt, e bërë nga inxhinierët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe ndihmuar nga inxhinierët e OJQ-së DT, për renovimin e 10 njësive banesore nevojiten rreth 150,000 Euro.

21.3 Bonus Banimi

Sipas 'Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim' lejohet që familjeve në nevojë për banim t'iu ndihmohet përmes pagesës së një pjese të qirasë.

Komuna e Fushë-Kosovës edhe në të kaluarën i ka ndihmuar familjet me këtë lloj të ndihmës. Nga viti 2015 Komuna e Fushë-Kosovës i ndihmon 14 familje me bonus banimi. Sipas analizave të bëra këto familje janë në gjendje të vështirë financiare dhe sociale dhe planifikohet që të ndihmohen edhe tre vitet në vijim.

Po ashtu planifikohet që kjo metodë të zgjerohet dhe për tre vitet në vijim, për sa po përpilohet programi, të ndihmohen edhe gjashtë familje të reja.

Pra, në total mendohet që me bonus banim të ndihmohen njëzet familje.

22. Analiza e fakteve dhe projektet në bazë të programeve

Të dhënat				
Llojet e programeve të konsideruara si të nevojshme		Renovimi 10 objekteve ekzistuese për banim në Miradi të Epërme		
		Banesa me bonus banimi: Komuna e Fushë-Kosovës planifikon të ndihmojë 20 familje në total.		
	Prezantimi i gjendjes faktike	1. Komuna e Fushë-Kosovës nuk ka ndërtesa të banimit kolektiv të ndërtuara në pronësi të komunës dhe me PPP, një pjesë e të cilave jepen me kontratë qiraje - qira jofitimprurëse për kategori të ndryshme 2. Komuna e Fushë-Kosovës ka objekte të dala jashtë funksionit, si rezultat i mungesës së mirëmbajtjes dhe që mund të adaptohen në funksion të banimit për programet e veçanta të banimit, të cilat janë në pronësi komunale apo pronësi shoqërore tjetër që mund të transferohet. 3. Komuna e Fushë-Kosovës planifikon të ndihmojë 20 familje me bonus banim. Qiraja për këto familje do të jetë përgjysmë, siç e parasheh edhe ligji.		
3.	Kërkesat faktike për përkrahje me sigurim të banimit	a. 11 familje nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale; b. Nuk kemi familje që kanë mbetur pa shtëpi, si pasojë e dëmtimeve	d. 4-të riatdhesuar, të kthyerit dhe komunitetet: rom, ashkalinj dhe egjiptian;	f. _____ Të moshuarit Të rinjtë Të punësuarit nga buxheti shtetëror

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS
PROGRAMI KOMUNAL TREVJEÇARI BANIMIT NË KUADËR TË LIGJIT NR. 03/L-164
PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË BANIMIT

		të shtëpive gjatë luftës së fundit; c. Nuk kemi të dhëna se sa familje posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike;	e. 43. të riatdhesuarit, të kthyerit dhe komunitet: rom, ashkalinj dhe egjiptian.	
4.	Veprimet kryesore që do të ndërmerren	• Të sigurohen mjetet financiare; • Të përzgjedhen përfituesit përmes një procesi transparent; • Të renovohen objektet në Miradi të Epërme;		
5.	Justifikim i veprimeve dhe shpjegimin e rezultateve.	Rezultatet e pritura (në formularin e projekteve)		
6.	Kohëzgjatja e realizimit të programeve	2018 - 2020		
7.	Kornizën e shpenzimeve	Afatshkurtër 6 mujore	Afatmesëm 1-2 vite	Afatgjatë 2-3 vite
		Përzgjedhja e përfituesve	Renovimi i objekteve ekzistuese të banimit në Miradi të Epërme Pagesa e bonus banimit (qirasë) për 20 familje;	Vendosja e familjeve dhe vazhdimi i pagesës së qirasë;
8.	Mundësitë e kapaciteteve njerëzore dhe materiale	-Nevoja e formimit të 'Sektorit të banimit' në kuadër të Komunës - Përkufizimi i lokacioneve - Planifikimi i buxhetit komunal		
		2018	2019	2020

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS
PROGRAMI KOMUNAL TREVJEÇARI BANIMIT NË KUADËR TË LIGJIT NR. 03/L-164
PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË BANIMIT

9.	Mënyra e financimit të programeve trevjeçare	Buxheti komunal Niveli qendror- MMPH, MPB, MPMS, MKK Donatorët, PPP	Buxheti komunal Niveli qendror- MMPH, MPB, MPMS, MKK Donatorët	Buxheti komunal Niveli qendror- MMPH, MPB, MPMS, Donatorët	
10.	Përputhja e programeve me Planet Zhvillimore të Komunës	PZHK dhe PZHU i miratuar – janë definuar zonat e banimit të të gjitha vendbanimeve.			
11.	Instrumentet mbikëqyrëse	Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit Zyrtari për Banim – periudhë afatshkurtër Zyra e Kryetarit Sektori i Banimit – afatmesëm Agjencia për Banim – afatgjatë			
12.	Instrumentet e garantimit të realizimit të programeve	Programet e caktuara, monitorimi, Raportet periodike Vendimet e Kuvendit			
13.	Transparenca me hartimin dhe zbatimin e programeve	Analiza e vazhdueshme e nevojave për banim Debati publik me grupet e caktuara Publikimet, raportet, informimi i vazhdueshëm			
14.	Analizat SVOT	Anët e forta	Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
		Korniza Ligjore PZHK, PZHU	Mungesa Fondeve të nevojsh me	Donatorë për këto programe, rritja e buxhetit komunal për banim	Kriza Politike

23. Justifikimi i veprimeve dhe shpjegimi i rezultateve të pritshme

Programi për banim i Komunës së Fushë-Kosovës mbulon periudhën 2018+6-2020. Komisioni, me ndihmën e OJQ-së DT, ka përgatitur propozimet për projektet prioritare zbatimi i të cilave rezulton në arritjen e synimeve zhvillimore të përcaktuara në fushat kyçe: detyrimet, aktivitetet, bartësit kryesor, afatin kohor të implementimit, përgatitjes dhe koordinimit të aktiviteteve të përgjithshme për implementimin e projekteve.

Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara, brenda mundësive ligjore dhe buxhetore, do të shqyrtohet mundësia për formimin e 'Sektorit të banimit' i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

'Sektori i banimit' do të jetë është një organ i përhershëm që do të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga 'Programi i banimit', si:

- Rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit
- Mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

Procesi i monitorimit do të përfshijë këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit të Programit - në krahasim me Planin e Veprimit;
- Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore;
- Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve (individët, organizatat);
- Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjedhjeve të ndikuara nga faktorët tjerë – harmonizimi.

Rezultatet pas zbatimit

Programi është hartuar në mënyrë që mund të matet dhe të monitorohet.

Monitorimi është një tipar i domosdoshëm për shkak se ai siguron që veprimet janë zbatuar dhe se përpjekjet janë duke u bërë për të siguruar përshtatjen me ndryshimet në burimet e favorshme dhe të nevojshme.

Pas përfundimit të çdo projekti në mënyrë transparente do t'i komunikohet publikut mbi statusin.

Projekti - të paktën të përmbajë:

- Cilat janë qëllimet!
- Cilët janë treguesit e performancës!
- Cila është rëndësia e projektit të realizuar!

Për të gjitha këto do të t'i raportohet çdo vit Kryetarit të Komunës dhe do të zhvillohet vlerësimi i performancës.

24. Themelimi i 'Sektorit të banimit'

Programi për banim i Komunës së Fushë-Kosovës mbulon periudhën 2018 - 2021. Komisioni ka përgatitur propozimet për projektet prioritare zbatimi i të cilave rezultojnë në arritjen e synimeve zhvillimore të përcaktuara në fushat kyçe: detyrimet, aktivitetet, bartësit kryesor, afatin kohor të implementimit, përgatitjes dhe koordinimit të aktiviteteve të përgjithshme për zbatimin e projekteve.

Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara do të shqyrtohet mundësia për formimin e 'Sektorit të banimit' i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

'Sektori i banimit' është një organ i përhershëm që do të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit, si: rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

Nga të dhënat e mësipërme, si prioritet do të zhvillohen programet e cekura:

- 10 familje do të ndihmohen përmes renovimit të objekteve në fshatin Miradi e Epërme;
- 20 familje do të ndihmohen përmes pagesës së qirasë. Në këtë grup hyjnë edhe 14 familje të cilave Komuna e Fushë-Kosovës veçse është duke iu paguar qiranë nga viti 2015, 2016 dhe 2017;

25. Mënyra e financimit të programeve trevjeçare

	Grandet e parapara për financim	2018	2019	2019
1.	Ndërtimi i shtëpive për raste të rënda socio-ekonomike	150,000.00	190,000.00	220,000.00
2.	Renovimi i shtëpive për raste të rënda socio-ekonomike	58,185.00	50,000.00	100,000.00
3.				
4.				

5.				
----	--	--	--	--

- Të bëhet Plani financiar i parashikuar dhe të garantohet përdorimi efikas i tij;
- Pjesë e buxhetit komunal;
Procedurat – auditivi, raportimi;
Burimet tjera të cilat mund të përdoren ose mund të ndihmojnë për zbatimin e programeve;
Do të qartësohen kategoritë e shpenzimeve:
Aplikim në fonde
Krijim i partneritetit me autoritetet qendrore si: MMPH, MPMS, MSH, MPB, institucionet tjera, bankat;
- Parashikimi i nevojave për vitet e ardhshme, bazuar në analiza dhe metoda shkencore të besueshme, parashikimin e nevojave për vitet e ardhshme-bazuar në analiza dhe metoda shkencore të besueshme.

Plani vjetor i punës në kuadër të drejtorisë kompetente – fusha e banimit
analizat dhe krijimi i bazës së të dhënave.

26. Burimet për financimin e programeve trevjeçare të banimit

- Të hyrat vetjake
Donatorët
PPP
Planifikimi i buxhetit - min. 1% e buxhetit total për vitet në vijim
- Mundësia e financimit me nivelin e të hyrave.
Fondi nga shitja e banesave
Taksë e veçantë në kuadër të lejeve të ndërtimit për ndërtesat kolektive (me theks rastet të cilat definojnë me bonus banim).
Vendosja në prioritetet e komunës – planifikimi i buxhetit
Plani Vjetor i Punës në kuadër të drejtorisë kompetente – fusha e banimit

27. Përputhja e programeve me Planet Zhvillimore të Komunës

Harmonizuar me PZHK dhe PZHU

28. Ndërlidhja e programeve me programet e përgjithshme dhe orientimet e politikave të qeverisjes qendrore

- Pjesë e programeve nga fusha e banimit me autoritetet qendrore.

29. Instrumentet e mbikëqyrjes

‘Sektori i banimit’ i cili do të formohet në kuadër të DPUMM-së dhe më pas Agjencisë për Banim, i cili do të financohet nga Komuna, ka për detyrë që të zhvillojë aktivitetet e mirëmbajtjes, implementimin e programit të banimit dhe zhvillimin e programeve tjera duke përcjellë dhe analizuar në vazhdimësi situatën e banimit.

30. Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve

Burimet njerëzore:

Autoritetet kompetente: ‘Sektori i banimit’ apo ‘Agjencia për Banim’ që kanë për detyrë të raportojnë për të gjitha aktivitetet në fushën e banimit në çdo 6 muaj Kuvendit të Komunës;

Të përcjellin të gjitha të dhënat lidhur me mundësitë e financimit nga programet e ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare;

Të planifikojnë buxhetin, krahas buxhetit komunal dhe burimeve tjera relevante, nga fusha e banimit;

Të përcjellin-monitrojnë situatën në vazhdimësi të banorëve të cilët janë pjesë e këtyre programeve;

Dhe të tjera, varësisht nga zhvillimet në komunë, mundësitë e bashkëpunimit ndërkomunal për raste specifike.

31. Masat që janë marrë për respektimin e kuadrit ligjor

Kjo pjesë do të jetë në vazhdimësi pjesë e punës së autoriteteve komunale për të cilat do të zbatohet monitorimi dhe auditivi.

32. Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparencës

Qytetarët e Komunës, do të kenë të drejtën të dinë për mënyrën se si shpenzohen të ardhurat e Komunës në tërësi dhe ato të programeve trevjeçare në veçanti, gjë e cila do të sigurohet duke u përfshirë edhe ata në procesin e sigurimit të transparencës, si:

- Zhvillimin e takimeve konsultuese me publikun;
- Bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit të publikut;

- Bërjen publike të programeve dhe projekteve që përfshijnë ato;
- Sigurimit të pjesëmarrjes së publikut gjatë diskutimeve që organet përkatëse do të zhvillojnë për: hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve;
- Bërjen e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vend, njoftimet komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut;
- Çdo masë tjetër e cila vlerësohet e nevojshme në përmbushje të këtij qëllimi.

33. Çështje të tjera

Gjatë hartimit të programeve trevjeçare janë marrë parasysh këto standarde:

- Realizueshmëria
- Qëndrueshmëria
- Efektshmëria
- Mjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe materiale
- Respektimi i ligjit
- Barazia
- Ndikimi në mjedis dhe energjia e pastër
- Normat e banimit
- Ndërthurja e këtyre programeve me politikat qendrore të banimit
- Transparenca
- Standarde të tjera

34. Analiza sot

PËRPARËSITË	DOBËSITË
• Ekzistimi i dokumenteve planore • Ekzistimi i iniciativave për PPP në fushën e ndërtimeve-banimit • Infrastruktura në zonat urbane • Subjektet ekonomike shfrytëzuese • Nevoja për zona të reja të banimit • Ekzistimi i zonave rezervë të planifikuara për banim • Ligjet nga fusha e banimit	• Parcela të vogla • Mungesa e hapësirave për shërbime • Oferta dhe kërkesa jo të harmonizuara • Kosto e lartë e pajisjes me inf. adekuate • Ndërtimet pa leje

• Burimet njerëzore autoritetet komunale të përkushtuara për kategoritë e rrezikuara • Regjistrimi i popullsisë • Të dhënat për kërkuesit • Mbulueshmëria me infrastrukturë • Strategjitë komunale • Ndërtimi i objekteve me këtë karakter • Interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në këto programe • Ekzistimi i objekteve të vjetra të banimit të cilat mund të adaptohen për banim dhe të shtohet fondi banesor.	• Kosto e lartë e banimit dhe kualiteti i ndërtimit joadekuat • Vonesat në procesin e legalizimit dhe procedurat • Kapacitete jo të mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimit social • Masa jo të mjaftueshme që ndërmerren për kategoritë e caktuara • Mungesa e interesimit të grupeve tjera për pjesëmarrje në këtë, sidomos të rinjtë • Analiza e banimit nuk është në masë të duhur që përfshin të gjithë indikatorët të cilët do të mundësojnë ndërtim kualitativ të banimit. • Pronësia e paqartësuar ... AKP • Mirëmbajtja e objekteve të banimit kolektiv jo e organizuar.
• MUNDËSITË	• RREZIQET
• Ligjet dhe Programet shtetërore për banim • Strategjitë komunale dhe qendrore • Formimi i 'Sektorit për banim' • Skemat garantuese • Programet në nivel komunal • Stimulimet për grupet e caktuara, • Programet në nivel qendror në mbështetje në nivel lokal nga fusha e ndërtimit/banimit. • Ligjet përkatëse të inkurajojnë zhvillimin e banimit (Ligji PPP) • Linja të favorshme të bankës, kreditë për banim • Mbështetje për ndërtimet në pronësi private – procedurat përmirësimin e tyre.	• Kriza Politike • Mungesa e fondeve në nivel lokal • Kontroll jo i mjaftueshëm nga fusha e ndërtimeve • Vonesat si dhe procedurat nga AKP

• Programe mbështetëse nga partner kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e banimit.	
---	--

35. Përfundimet

Nevoja për hartimin dhe zbatimin e efektshëm të planit për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të të gjitha strukturave në kuadër të Komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është i nevojshëm formimi i ‘Sektorit për banim’ si organi përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij Plani. Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë dhe Partneritetit Publik - Privat, që do të sigurojë banimin për grupe të caktuara.

Përmirësimi i kualitetit të banimit duke pasur parasysh objektet ekzistuese të banimit kolektiv që në një masë sektori i banimit do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes dhe motivimin e pronarëve të njësive të banimit si domosdoshmëri e organizimit dhe menaxhimit.

Bazuar në këtë, zhvillimi i banimit orientohet nga:

- Përkrahja në zgjidhjen e çështjes së banimit me banimit me qira jofitimprurëse ose në bonus të banimit për banesat e tregut me qira të ulët;
- Stimulim i ofertës dhe kërkesës;
- Mbështetje për grupet e rrezikuara për zgjidhjen e problemit të banimit;
- Rritja e ofertës së banesave jofitimprurëse, zvogëlimin-kufizimin e profitit nga ndërtimet, por jo të rrezikohet interesi i investitorëve që të zhvillojnë aktivitetet ndërtimore të banimit.
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i fondit banesor.

Nr. _____ 2018

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha